



Prishtinë: 27.05.2009

Kodi i ZRRE-së: V_184_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_211_05_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_211_05_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 26.05.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:

VENDIM

REFUZHET ankesa e konsumatorit Milazim Hoti (shifra e konsumatorit DPZ – 54942) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 13.05.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 24.04.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 01.08.2008 ekipet inspektuese të KEK-u kane bërë ndërrimin e njehsorit elektrik nr 30201891 dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr 44193195.
Provë: Procesverbali për ndërrimin e njehsorit të datës 01.08.2008
- Ndërrimi i njehsorit është bërë pasi qe ekipet inspektuese të KEK-ut kanë vërejtur se njehsori nuk është ne gjendje të rregullt.
Provë: Procesverbali për ndërrimin e njehsorit të datës 01.08.2008
- Me datë 29.09.2008 Qendra e laboratorit te kalibrimit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit nr 30201891 dhe ka konstatuar se për rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmi, dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik.
Provë: Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit nr. 9/29 të datës 29.09.2009

- Me datë 09.02.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPZ21HP04641 në shumë prej 1,500.78 €
Provë: Fatura DPZ21HP04641 të datës 09.02.2009
- Me datë 27.03.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.
Provë: Deklarata e konsumatorit në KEK
- Me datë 24.04.2009 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në faktet dhe argumentet e paraqitura ne përgjigje.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 24.04.2009
- Me datë 13.05.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e KEK-ut në DMK të ZRRE-së
- Me datë 13.05.2009 DMK ka në ZRRE ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me kontestimin e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 13.05.2009
- Me datë 26.05.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_211_05_09.
Provë: Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_211_05_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prizren, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar

Dr. Nysret Avdiu, anëtar